



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 33
Prishtinë, më 29 maj 2012, në orën 9:45
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Nga takimi i Komisionit për Punë të Jashtme me delegacionin e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Madh Kombëtar të Republikës së Turqisë

Delegacioni i Komisionit për Punë të Jashtme i Kuvendit të Madh Kombëtar të Republikës së Turqisë, ishte në përbërje: z. Volkan Bozkir, kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme, znj. Songül Ozan, ambasadore e Republikës së Turqisë në Kosovë, anëtarët e Komisionit: z. Burhan Kajatürk, z. Rıfat Sait, z. Faik Tunay, z. Sinan Ogan; z. Aydın Evirgen- këshilltar i Komisionit, z. İzzet Anıl Turpcu-ekspert i Komisionit dhe z. Berker Ülker- zyrtar i protokollit.

Në takim morën pjesë: z. Albin Kurti, z. Hydajet Hyseni, z. Enis Kervan, z. Shaip Muja, z. Sabri Hamiti, z. Skender Hyseni, znj. Donika Kadaj- Bujupi, z. Amir Ahmeti dhe z. Petar Miletij.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi, Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim me delegacionin e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Madh Kombëtar të Republikës së Turqisë

Albin Kurti -Falënderoi për gatishmërinë e delegacionit turk për ta vizituar Kosovën. Këtë takim të përbashkët e konsideroi të vlefshëm dhe të dobishëm për të gjithë. Për përkrahjen e Kosovës nga Turqia, para luftës, gjatë luftës, pas luftës dhe për njohjen e pavarësisë së saj ndër vendet e para, theksoi se jemi falënderues dhe mirënjohës.

Ai tha se ndër sfidat e Kosovës janë: mosnjohja ende nga pesë vendet e BE-së, rritja e numrit të njohjeve dhe vështirësitë në konsolidimin e brendshëm, që kanë të bëjnë me qytetin e ndarë të Mitrovicës dhe strukturat ilegale të Serbisë.

Po ashtu, ai përmendi nevojën që ka Kosova për investime dhe zhvillim ekonomik, sidomos në bujqësi dhe industrinë e lehtë, duke pasur parasysh papunësinë e madhe, moshën e re të popullsisë dhe resurset natyrore të cilat i posedon.

Volkan Bozkir- U shpreh se ndjehet i kënaqur për këtë vizitë që po e realizon delegacioni turk në Kosovë dhe për mikpritjen e ngrohtë që po ju bëhet këtu. Njoftoi anëtarët e Komisionit për rrugëtimin dhe reformat e Turqisë drejt zhvillimit ekonomik, negociatat e saj shumëvjeçare për anëtarësim në BE, zhvillimin ekonomik dhe standardet e arritura tani në Turqi. Shprehu bindjen e tij se të arriturat demokratike dhe të shtetndërtimit të Kosovës, janë më të mëdha sesa ngecjet e saj në këtë proces, me shpresë se në një ardhme jo shumë të largët, Turqia dhe Kosova do të jenë anëtare të NATO-s dhe BE-së. Z. Bozkir njoftoi se Turqia mbështetë Kosovën edhe në takimet e saj ndërkombëtare dhe lobon për njohje të reja të Kosovës.

Hydajet Hyseni - Theksoi se pozicioni i Turqisë nuk ka vija ndarëse globalizimi, e po ashtu edhe pozicioni i Kosovës, prandaj është mirë që Kosova të shfrytëzojë përvojat e Turqisë, lidhur me zhvillimin ekonomik të saj në deceniet e fundit. Turqia tani është një vend i zhvilluar dhe përvoja e zhvillimit ekonomik të saj është e rëndësishme për Kosovën. Kosova ka resurse natyrore dhe burime njerëzore, të cilat me pak investime nga jashtë, do të shndërroheshin në progres të përgjithshëm për Kosovën.

Përvoja e Turqisë, lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe lirive fetare, tha se do të ishte një shembull i mirë për ne, në ruajtjen e raporteve ndëretnike e ndërjetare.

Ai theksoi se, tani kur Kosova gjendet në fazën e finalizimit të projektit të pavarësisë së saj, ka tendenca të bllokimit të këtij procesi dhe, në këtë drejtim, përfundimi i njohjeve ndërkombëtare do të parandalonte praktikisht tendencat për krijimin e krizave të reja. Falënderoi për ndihmën e madhe që ka dhënë Turqia për Kosovën dhe kërkoi që ajo të ndikojë në vendet e Kaukazit, të cilat hezitojnë ta njohin pavarësinë e Kosovës. Pavarësia e Kosovës është një zgjidhje kompromisi në favor të të gjitha komuniteteve dhe mund të jetë shembull i mirë për vendet që kanë probleme.

Sabri Hamiti - Delegacionit të Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Madh Kombëtar të Turqisë, i dëshiroi mirëseardhje dhe shtoi se në mes të dy komisioneve ekzistojnë raporte institucionale. Komisioni ynë, para tri vitesh, ka realizuar një vizitë zyrtare në Turqi ku ka pasur takime shumë produktive edhe me kryetarin e asaj kohe të KPJ të Kuvendit të Turqisë, z. Mercan. Po ashtu, jemi takuar edhe në vitin 2010, me rastin e organizimit të takimit të komisioneve të jashtme të rajonit, me ç'rast kemi nxjerrë një deklaratë të përbashkët, e cila bënte thirrje për njohjen e Kosovës nga të gjitha shtetet e rajonit.

Kosova ka nevojë për partneritet, bashkëpunim, fqinjësi të mirë dhe të ndërtohet në të gjitha nivelet, në zhvillimin e brendshëm dhe në komunikimet me rajonin e tutje. Kosova ka nevojë për njohje, ka ngecje në njohje, kryesisht nga vendet ortodokse në vijë vertikale evropiane. Kosova, pa marrë parasysh përbërjen e popullsisë, është e ndërtuar si një shtet multietnik, me të drejta përtej normave dhe përqindjes së minoriteteve, që nuk i ka asnjë shtet në Evropë.

Skender Hyseni - Theksoi se vazhdimi i ndërtimit të partneritetit dhe përkrahja nga Republika e Turqisë është e nevojshme për Kosovën. Kosova ende është në fazën e konsolidimit të shtetësisë së saj, ka nevojë për njohje të reja, për të cilat Turqia ka mundësinë e ndikimit tek një numër jo i vogël i shteteve. Po ashtu, Kosova ka nevojë për bashkëpunim me Turqinë në të gjitha fushat dhe intensifikim të bashkëpunimit ekzistues.

Falënderoi për ndihmën e dhënë nga kontingjenti turk i KFOR-it, si dhe për përkrahjen nga projektet e organizatës TIK-a.

Amir Ahmeti- Vlerësoi rolin e Turqisë në zhvillimin e Kosovës, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë politik. Për Komisionin për Punë të Jashtme, si një komision më i ri, theksoi se është e nevojshme përvoja e Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Madh Kombëtar të Turqisë. Meqenëse Turqia tani ka një rol shumë të rëndësishëm për zhvillimet rajonale që po ndodhin në Lindjen e Mesme dhe më gjerë, tha se roli i Turqisë për njohje të reja të Kosovës është shumë i rëndësishëm në atë pjesë të botës. Duke pasur parasysh faktin se Turqia është nikoqire e shumë takimeve rajonale, kërkoi që të ftohet edhe KPJ i Kuvendit të Kosovës, me ç'rast do të mund të zgjeroheshin kontaktet edhe me shtetet e tjera, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, ku diplomacia parlamentare do të mund ta luante rolin e saj.

Në këtë takim, deputetët e delegacionit turk, z. Rifat Sait dhe z. Sinan Ogan, të cilët në diskutimin e tyre njoftuan se Kosova gëzon përkrahjen e Turqisë, është ndihmuar gjatë luftës dhe do të vazhdojë të ndihmohet në aspektin e lobimit dhe të investitorëve turq.

Albin Kurti - Falënderoi delegacionin për këtë takim të përzemërt dhe të dobishëm, duke shtuar se jemi për marrëdhënie e komunikim të ndërsjellët, të drejtë e të barabartë, në formë të partneritetit, i cili duhet të intensifikohet në sa më shumë fusha, me pjesëmarrje të të dyja palëve.

Takimi përfundoi në orën 10:55.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti